

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt. 20.02.2008 nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-292588/19 dt. 29.11.2019, të pronarit /investitorit Mirvete Kelmendi me vendbanim në Prishtinë, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, të shndërrimit të hapësirës banuese në hapësirë afariste e cila ndodhet në kuadër të ndërtesës me etazhitet B+P+4, në Lagjen Ulpiana, rruga “Mark Dizdari”, Blloku D6-H2, Nr. 1, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datën 05.07.2021 lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LËSHOHET Certifikata e përdorimit pronarit /investitorit Mirvete Kelmendi me vendbanim në Prishtinë, sipas kërkesës 05 Nr.391/02-292588/19 dt. 29.11.2019, për përdorimin e hapësirës së shndërruar nga hapësira banuese në hapësirë afariste, sipas vendimit 05 Nr. 351/02-0183046/17 të datës 16.11.2017 e cila ndodhet në kuadër të ndërtesës me etazhitet B+P+4, në Lagjen Ulpiana, rruga “Mark Dizdari”, Blloku D6-H2, Nr. 1, në Prishtinë.

II. Ndërtesa/hapësira, mund të përdoret, sipas destinimit të përcaktuar në pikën I. të Vendimit të Lejes Ndërtimore 351/02-0183046/17 të datës 16.11.2017, dokumentacionit ndërtimor dhe Njoftimin e Inspektimit Final, nga Inspekcioni i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës.

III. Ndërtesa/hapësira mund të përdoret nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate.

IV. Kjo Certifikatë shërben për regjistrimin e ndërtesës në regjistrin kadastral të përshkruar në pikën I. të këtij vendimi.

V. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas shtojca 6 e Udhëzimit Administrativ MMPH. Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Invetitori/pronari Mirvete Kelmendi me vendbanim në Prishtinë, më kërkesën me 05 Nr.391/02-292588/19 dt. 29.11.2019, i është drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së

përdorimit për hapësirën e shndërruar nga hapësira banuese në hapësirë afariste, në lokacionin e përshkruar si në pikën I. të dispozitivit të kësaj certifikate.

Nga Drejtoria e Inspektionit-Spektori i ndërtimit i Komunës së Prishtinës përmes shkresës zyrtare "Njoftim mbi inspektimin final me referencë 09 Nr. 391/02-182254/19 dt. 15.06.2021, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizmit, Raportin e Inspektionit final të punëve dhe përshkrimin të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspektionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, investitori ka prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e udhëzimit administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektionit shtojca 2 dhe 4/a deri 4/f

- Vendimin nr. 05 Nr.351/02-013046/17 dt. 16.11.2017 për lejimin e ndërtimit të destinimit të përdorimit të hapësirës baneosre në hapësirë afariste në katin përdhësë të ndërtesës shumëbanesore me etazhitet B+P+4 të jesisë banesore nr. 1 në Lagjen "Ulpiana", rruga "Mark Dizdari", Blloku D6-H2, në Prishtinë.
- Aktvendimin me nr. 05 Nr. 351/02-0183046/17 dt. 25.09.2017, mbi caktimin e taksës administrative për lejen e ndërtimit të destinimit të përdorimit të hapësirës baneosre në hapësirë afariste.
- Vendimin me nr. 05 Nr. 351/02-108413/18 dt. 02.11.2017 për plotësimin dhe ndryshimin e aktvendimit 05 Nr. 351/02-0183046/17 dt. 25.09.2017 mbi caktimin e taksës administrative për lejen e ndërtimit të destinimit të përdorimit të hapësirës baneosre në hapësirë afariste.
- Dëshmi mbi pagesën e taksës administrative për leje të ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës.
- Raportin e mbikëqyrjes profesionale për secilën nga fazat e projektit si dhe raportin e udhëheqësit të punishtes, Dijamant Kabashi, IDN. udhëheqës i vend ndërtimit, Ferdane Kuleta, IDA. mbikëqyrës për arkitekturë, Hilmi Mulaku, IND. mbikëqyrës për Strukturë, Anita Kabashi, IDH. mbikëqyrës për Hidro-Instalime, Osman Gwrxhaliu, IDE. Mbikëqyrës për Instalime elektrike, Besim Ibrahim, IDM. Mbikëqyrës për Instalime makinerike, Hilmi Mulaku, mbikëqyrës për instalimet për mbrojtje nga zjarri.
- Protokollin e miratuar për të gjitha fazat e ndërtimit,
- Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve,
- Fotografitë gjatë procesit të ndërtimit,
- Kopjet e diplomave të inxhinierëve mbikëqyrës të objektit,

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, konkretisht Njoftimit mbi Inspektimin Final të ndërtimit të ndërtesës nga Inspektioni me referencë 09 Nr. 391/02-182254/19 dt. 15.06.2021, dhe pas dorëzimit të dokumentacionit nga ana e investitorit, përmes kërkesës 05 Nr. 391/02-292588/19 dt. 29.11.2019 ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve mbikëqyrës fazave të ndërtesës: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, instalimeve makinerike, mbrojtjes nga zjarri dhe punëve zejtare si dhe matjeve gjeodezike, konstatohet se ndërtesa është realizuar në përputhshmëri të plotë me Ligjin e Ndërtimit Nr. 04/L-110, projektin kryesor, Lejen e ndërtimit të destinimit të hapësirës 05Nr.391/02-0183046/17 dt. 16.11.2017. Po ashtu theksohet se punët janë zhvilluar në harmoni me projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumë banesore me afarizëm, mund të përdoret.

Në Njoftimin mbi inspektimit final të lëshuar nga Drejtoria e Inspektionit-Sektorit i Ndërtimit, është konstatuar se të gjitha punimet në objekt janë të përfunduara, dhe se udhëzohet pala që të vazhdoi procedurat për pajisje me certifikatë të përdorimit. Po ashtu edhe kërkesat që dalin nga Ligji për Ndërtim Nr.04/L-110, neni 27 janë të aprovuara nga ana e Mbikëqyrjes Profesionale të angazhuar nga ana e Poseduesit të Lejes Ndërtimore.

Kërkesat e Vendimit Lejes Ndërtimore janë zbatuar,

Të gjitha mbetjet janë larguar nga vendi i ndërtimit dhe janë dërguar në një vend adekuat për deponimin e mbeturinave,

Masat për kursim të energjisë janë zbatuar.

Kjo drejtori, bazuar në raportet e prezantuara dhe konstatimet e lartcekura, vendosi që hapësira me destinimin banim e shndërruar në hapësirë afariste, mund të përdoret/shfrytëzohet, gjegjësisht të lëshojë certifikatën e përdorimit për këtë ndërtesë.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.


Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certificate, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MEA-ja.

I dorëzohet: Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspektionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-292588/19 DT. 05.07.2021**

Zyrtari:

Berim Osmanaj



U.D. Udhëheqëse e sektorit

Mimoza Berisha Frestreshi



Drejtori:

Arđian Oluri



